



Fuqizimi i Familjeve Tona

Të dashur familjarë dhe kolegë,

Si arsimtar me përvojë të gjatë dhe prind në New York City Public Schools (Shkollat Publike të Qytetit të Nju-Jorkut), e di nga përvoja personale se sa i rëndësishëm është fuqizimi i familjeve. Prindërit dhe kujdestarët duhet të mirëprehen, të respektohen dhe të vlerësohen në komunitetet tona shkollore. Ky është një nga [tre angazhimet](#) që mora kur u bëra kancelare për herë të parë, së bashku me sigurinë e nxënësve dhe mbështetjen e arsimtarëve. Pra, ndërsa nisim vitin, ja disa mënyra se si po sigurohemi që familjet të jenë të përfshira dhe të dëgjua në çdo hap të vendimmarrjes.

- **Family Connectors (Lidhësit Familjarë):** Si pjesë e iniciativës tonë “NYCPS Cares” (NYCPS kujdeset), këta vullnetarë lidhin prindërit dhe kujdestarët me shërbimet dhe burimet e qytetit. Ju nxis të [mësoni më shumë dhe të shprehni interesin tuaj](#) për t'u bërë një Family Connector (Lidhës Familjar)!
- **Akresi gjuhësor:** Këtë verë përditësuam [Rregulloren A-663 të kancelarit](#), në mënyrë që akoma më shumë familje të mund të marrin materiale shkollore në gjuhën e tyre të preferuar. Vizitoni faqen tonë të internetit për të [mësuar më shumë rreth shërbimeve të përkthimit dhe interpretimit](#).

- **Udhëheqja nga prindërit:** Familjet i bëjnë shkollat tona më të forta duke kontribuar me zërin e tyre në [strukturat udhëheqëse me pjesëmarrjen e prindërve](#). I nxis familjet të informohen më shumë rreth [këshillave arsimorë të komunitetit dhe të qytetit](#) dhe të marrin në konsideratë aplikimin për [vendet vakante](#), në mënyrë që të ndihmojnë në formësimin e sistemit tonë shkollor.
- **Koordinatorët e prindërve:** Koordinatorët e prindërve janë anëtarë të stafit të shkollës, të cilët janë të përkushtuar për të siguruar që familjet të përfshihen dhe të angazhohen në komunitetet e tyre shkollore. Gjeni një koordinator të prindërve duke përdorur [mjetin tonë “Find a School”](#) (Gjej një shkollë).
- **Takimi mes prindërve dhe mësuesve:** Raundi i parë i takimeve mes prindërve dhe mësuesve nisi këtë javë dhe do të vazhdojë për disa nivele klasash më 25 shtator. Për më shumë informacion, shikoni këto [këshilla për takimet](#).

Falënderoj stafin tonë për dedikimin dhe punën e palodhshme në emër të nxënësve tanë. Falënderoj prindërit dhe anëtarët e familjeve për bashkëpunimin dhe që na kanë besuar fëmijët e tyre. Ne jemi të gjithë jemi partnerë në këtë punë.

Në bashkëpunim,


Melissa Aviles-Ramos
Kancelare (Chancellor)

Rubrika kushtuar kancelares:

Family Connectors (Lidhësit Familjarë) po mbështesin aktivisht komunitetet tona: duke ndërtuar marrëdhënie, krijuar lidhje dhe rritur aksesin në burime të rëndësishme. Përvoja është domethënëse, si për familjet që marrin mbështetje, ashtu edhe për vetë Family Connectors (Lidhësit Familjarë). [Si një Family Connector \(Lidhës Familjar\)](#), “Të qenit Family Connector (Lidhës i familjeve) më ka ndryshuar jetën, sepse më ka dhënë mundësinë të mësoj informacione që kurrë nuk i dija se ekzistonin.” Falënderoj Family Connectors (Lidhësit Familjarë) për udhëheqjen!

Nomino një person ose program për rubrikën e Kancelares [këtu](#).

Video Kryesore: Aksesit gjuhësor



Për përkthime, ju lutemi vizitoni faqen tonë në [YouTube](#).

Për të aksesuar titrat e përkthyer: Klikoni mbi ikonën “CC”. Klikoni mbi ikonën “Settings (Cilësimet)” dhe zgjidhni “Subtitles/CC (Titrat/CC)”. Zgjidhni “Auto Translate (Përkthim Automatik)” dhe më pas zgjidhni gjuhën tuaj.

Lajme dhe burime nga NYCPS:

- Nga 15 shtatori deri më 15 tetor është muaji i trashëgimisë hispanike! Shikoni [burime edukative, ngjarje dhe materiale të rekomanduara për lexim](#).
- Gjeni [burime edukative, ngjarje dhe materiale të rekomanduara për lexim](#) në [The Morning Bell](#).
- Për lajme dhe burime të tjera, ndiqni NYCPS në online në [Facebook](#), [Instagram](#), [X](#) dhe [YouTube](#).
- Këtu është [videoja javore](#) nga Kryetari i Bashkisë Eric Adams. Mund të [regjistroheni për të marrë përditësime](#) drejtpërdrejt nga Mayor's Office (Zyra e Kryetarit të Bashkisë).

Familje të NYCPS: Nëse nuk dëshironi më të merrni këtë buletin informativ, ju lutemi [çaktivizoni abonimin](#).